

27.03.2010 "JERI"

ZËRI

08 DITARI

## Mbështeten 10 institucione të arsimit të lartë

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në themelimin, forcimin dhe sigurim të cilësisë në 10 institucione private të arsimit të lartë të Kosovës

**PRISHTINË** → Programet e TEMPUS-it duhet të gjejnë realizim edhe në Kosovë dhe institucionet e larta profesionale arsimore nuk duhet hequr dorë nga to edhe nëse realizimi i tyre në fillim do të jetë me një temp të ngadalshëm, thanë të premtën në Prishtinë zyrtarë të MASHT-it dhe Wus Austria.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Wus Austria në bashkëpunim me partnerët tjerë vendorë dhe evropianë, ka mbajtur të premtën takimin nismëtar të partnerëve për projektin "Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave për sigurimin e cilësisë në institucionet private të arsimit të lartë", të mbështetur përmes Programit TEMPUS, e të financuar nga Komisioni Evropian.

Qëllimi kryesor i projektit është të kontribuojë në themelimin, forcimin dhe sigurim të cilësisë në 10 institucione private të arsimit të lartë të Kosovës. Ndërsa qëllimi afatgjatë është përmirësimi i cilësisë së këtyre institucioneve në bazë të Strategjisë mbi arsimin e lartë për periudhën 2005-2015, parimeve të Procesit të Bolonjës si dhe dokumenteve të tjera relevante. Ministri i Arsimit, Enver Hoxhaj, tha se Republika e Kosovës gjatë vitit 2008/09 ka bërë përpjekje maksimale që ta definojë shtetin tonë të ri si shtet në të cilin dija dhe kërkimi shkencor janë shtylla për zhvillim ekonomik, për modernizim social dhe për zhvillim kulturor. "Por, përderisa sektori publik ekziston për shkak të domosdoshmërisë

publike, sektori privat duhet të ekzistojë për shkak të cilësisë dhe të fleksibilitetit që ka ekonomia jonë e tregut", tha ministri Hoxhaj.

But Dedaj, përfaqësues i Wus Austria theksoi se duke iu përgjigjur përkushtimit që ka pasur MASHT-i në këtë drejtim, "Ju kemi veshur punës që së bashku me

**Përfitues janë: Kolegji AAB-RIINVEST, Instituti Biznesi, Kolegji Dardania, Shkolla e lartë profesionale Evolucioni, Kolegji FAMA, Kolegji Iliria, Instituti Pjetër Budi, Shkolla e lartë profesionale Tempulli, Kolegji UBT dhe Instituti Universum.**

Universitetin e Strasburgut ta zhvillojmë këtë projekt, i cili do t'i kontribuojë zhvillimit të cilësisë në IPAL të Kosovës".

Përfaqësuesja e Komisionit European në Kosovë, Sophie Beamount tha se ky projekt do t'iu ndihmojë drejtpërdrejt studentëve, por edhe ekonomisë së Kosovës.

Përfitues të projektit janë 10 institucione private të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës: Kolegji AAB-RIINVEST, Instituti Biznesi, Kolegji Dardania, Shkolla e lartë profesionale Evolucioni, Kolegji FAMA, Kolegji Iliria, Instituti Pjetër Budi, Shkolla e lartë profesionale Tempulli, Kolegji UBT dhe Instituti Universum.